



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Kumtesë për Media

5 mars 2021

RrGK: Zgjedhjet dëshmuar forcën e grave, përpjekja për barazi vazhdon

Zgjedhjet parlamentare të 14 shkurtit 2021 sollën një ndryshim shpresëdhënës për pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grave në politikë dhe procese vendimmarrëse.

Krahasuar me zgjedhjet e kaluara (2019), përfaqësimi i grave në Kuvendin e Kosovës është rritur për pesë ulëse. Nga gjithsej 120 ulëse do të jenë 44 deputete apo 36.6%, kurse në legjislaturën e kaluar kjo shifër ishte 32.5% apo 39 deputete.

Për më tepër, edhe kësaj radhe më shumë gra janë zgjedhur pa kuotë se sa që janë zgjedhur falë saj. Sipas rezultateve të deritanishme të shpallura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vetëm 11 prej 44 deputeteve të zgjedhura kanë pasur nevojë për kuotë për të siguruar ulësen parlamentare, kurse 33 gra kanë fituar pa kuotën gjinore.

Kjo nuk është barriera e vetme që gratë thyen në këto zgjedhje. Ato arritën këtë përfaqësim sado që ishin të nënpërfaqësuar në listat zgjedhore të partive politike, kjo duke kujtuar se asnjë nga partitë politike, as këtë herë, [nuk zbatuan](#) Ligjin për Barazi Gjinore (LBGj).

Gratë po ashtu mposhtën faktin që nuk ishin të përfaqësuar barabartë as në debate televizive e as në fushatë. Numërimi i fuqisë së grave vazhdon me faktin që nga dhjetë më votuarit në këto zgjedhje, katër prej tyre janë gra. Për dallim nga zgjedhjet e kaluara kur në top dhjetëshe ishin vetëm dy gra. Zëri i gruas bëhet edhe më i fuqishëm kur vërejmë se mbi 60% të grave morën pjesë në votime, dhe se një grua [u bë](#) personi më i votuar në histori që pas shpalljes së pavarësisë.

Kjo është një fitore e lëvizjes së grave në Kosovë, e cila po ashtu dëshmon se vota e qytetarëve për gratë e sjell ndryshimin pozitiv e aq të nevojshëm. Kjo lëvizje feministe për më shumë se 15 vjet u mbështet dhe u forcua nga organizatat e shoqërisë civile që punojnë për të drejtat e grave, duke përfshirë këtu edhe kontributin e Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK) për fuqizimin e gruas në politikë në nivel lokal bashkë me Lobin për Barazi Gjinore ([Lobi](#)) ndër të tjerash.

Për kontekstin historik të këtij triumfi të grave, Zana Hoxha, Drejtore Ekzekutive e [Artpolis](#), si dhe anëtare e Bordit të RrGK-së, thotë “në fakt kjo është fitore historike e RrGK-së dhe lëvizjes së grave në Kosovë. Indikator i më i saktë që përpjekjet me dekada dhe vota nga gratë për gratë e sjell ndryshimin”.

“Njëherit, kjo situatë mund të shërbejë edhe si koha e fundit kur partitë politike duhet të reflektojnë se nuk ka thjesht e vetëm “çështje të grave”, por se barazia gjinore është çështje e të gjithë shoqërisë”, shton Kryetarja e Bordit të RrGK-së, Ariana Qosaj-Mustafa.

Megjithatë, përderisa jemi dëshmitarë të fuqizimit politik të grave në shoqërinë kosovare, RrGK [do të vazhdojë](#) përpjekjet e kahmotshme drejt rritjes së pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimmarrje, si dhe do të kërkojë llogaridhënie e transparencë për politikat që prekin mirëqenien dhe të drejtat e grave, si prej të zgjedhurve po ashtu dhe prej Qeverisë që pritet të formohet.